

L I G J
Nr. 8715, datë 15.12.2000

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8313, DATË 26.3.1998, “PËR
TATIMIN MBI BIZNESIN E VOGËL”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.8313, datë 26.3.1998 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1 “Subjektet e tatimit të biznesit të vogël”, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Subjekt i tatimit mbi biznesin e vogël është çdo person që kryen biznes në territorin e Republikës së Shqipërisë gjatë çfarëdo periudhe të vitit kalendarik, i cili realizon një xhiro vjetore deri në 8 milionë lekë dhe që nuk i nënshtrohet tatimit mbi vlerën e shtuar.”

Neni 2

Neni 5 “Tarifa e tatimit” ndryshohet si vijon:

“Tatimi mbi xhiron për tatimpaguesit që realizojnë shumën nga 2 deri në 8 milionë lekë, për çdo vit kalendarik, është 4 për qind e xhiros.”

Neni 3

Neni 6 “Deklarimi” ndryshohet si vijon:

“Deklarimi me shkrim i xhiros nga tatimpaguesi, për shumën nga 2 deri në 8 milionë lekë në vit, bëhet deri më 28 shkurt të vitit pasardhës.

Gjatë vitit, organet tatimore detyrohen të vërtetojnë vëllimin e xhiros së realizuar. Për këtë, ato kanë parasysh të dhënat nga arkat regjistruese, kuponat tatimore, librat e blerjes dhe të xhiros, të dhënat nga doganat, nga degët e thesarit etj., si dhe të dhënat e rezultuara nga fotografimet, kronometrimet, sipërfaqet prodhuese ose të shërbimit që ka tatimpaguesi, pozicioni i vendit të biznesit etj.”

Neni 4

Neni 7 “Dokumentacioni dhe regjistrimet” ndryshohet si vijon:

“1. Tatimpaguesi detyrohet të mbajë librin e xhiros. Në këtë libër, tatimpaguesi regjistron xhiron e realizuar çdo ditë. Xhiroja e realizuar gjatë ditës është shuma e shitjeve të realizuara, nëpërmjet kuponave tatimore ose dëftesave tatimore të lëshuara.

Tatimpaguesi detyrohet të mbajë librin e blerjeve. Në këtë libër, tatimpaguesi regjistron çdo ditë blerjet e bëra gjatë ditës. Shumat dhe blerjet ditore duhet të justifikohen me faturat tatimore të blerjeve (faturë e thjeshtë, e lëshuar nga tatimpaguesit e tjerë të biznesit të vogël ose faturë me TVSH, e lëshuar nga tatimpaguesit e regjistruar në TVSH). Librin e blerjeve nuk janë të detyruar ta mbajnë tatimpaguesit e pikave “Dh. Profesione”; “E.Ambulant, artizanat” dhe “Ë.Transport” të nenit 3 të ligjit nr.8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”.

Libri i xhiros dhe libri i blerjeve sekretohen nga organi tatimor i rrethit përkatës.

2. Të gjithë tatimpaguesit e biznesit të vogël, të pajisur me arkë regjistruese, janë të detyruar të lëshojnë kuponin tatimor për çdo shitje të kryer.

Të gjithë tatimpaguesit e tjerë të biznesit të vogël, të cilët nuk janë të pajisur me arkë regjistruese ose megjithëse e kanë atë, por për shkaqe të parashikuara në ligj nuk e përdorin, janë të detyruar të lëshojnë dëftesë tatimore. Dëftesa tatimore lëshohet në çastin e furnizimit me mall ose të shërbimit të kryer dhe në rastet e parapagimit në çastin e marrjes së parapagesës.

Format e dëftesës tatimore përcaktohen nga Ministri i Financave.

3. Kuponat ose dëftesat tatimore të shitjes, faturat e blerjes, librat e xhiros dhe librat e blerjeve ruhen për një periudhë jo më pak se 5 vjet.

4. Tatimpaguesit e biznesit të vogël janë të detyruar të paraqesin të gjithë dokumentacionin e mësipërm, kur ai u kërkohet nga organet tatimore.

5. Tatimpaguesit janë të detyruar të afishojnë, në çdo rast, çmimin përfundimtar të mallit që shesin ose të shërbimit që kryejnë.

6. Tatimpaguesit janë të detyruar, për qëllime kontrolli, të lejojnë hyrjen e punonjësve të organeve tatimore në mjediset e biznesit.”

Neni 5

Neni 8 “Pagesa” pika 4 ndryshohet si vijon:

“4. Tatimi mbi xhiron, në masën 4 për qind, paguhet 2 herë në vit dhe, konkretisht, brenda muajit shtator paguhet kësti i parë dhe brenda muajit nëntor paguhet kësti i dytë.”

Neni 6

Neni 9 “Përgjegjësia dhe shkeljet” ndryshohet si vijon:

“1. Përbëjnë kundërvajtje administrative këto shkelje:

a) Mosregjistrimi sipas kërkesave të përcaktuara në Kreun II.
b) Mosplotësimi i deklaratës siç është përcaktuar në Kreun III.
c) Mosnjoftimi i organeve tatimore për ndryshimin në emrin, adresën, vendin dhe llojin e biznesit etj.

ç) Mosekspozimi i certifikatës së regjistrimit sipas pikës 9 të nenit 4 të ligjit nr.8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”.

d) Mosparaqitja e certifikatës së regjistrimit nga tatimpaguesit ambulantë, kur ajo u kërkohet nga organi tatimor.

dh) Mospagimi i tatimit në afatet e caktuara.

e) Mosrespektimi i kërkesave të përcaktuara në pikën 1 të nenit 7 të ligjit nr.8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”.

ë) Moslëshimi i kuponit ose i dëftesës tatimore ose lëshimi i tyre me vlerë më të vogël se vlera reale.

f) Mosrespektimi i kërkesave të përcaktuara në pikën 3 të nenit 7 të ligjit nr.8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”.

g) Mosrespektimi i kërkesave të përcaktuara në pikën 4 të nenit 7 të ligjit nr.8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”.

gj) Mosrespektimi i kërkesave të përcaktuara në pikën 5 të nenit 7 të ligjit nr.8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”.

h) Mosrespektimi i kërkesave të përcaktuara në pikën 6 të nenit 7 të ligjit nr.8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”.

2. Për shkeljet e mësipërme jepen këto dënime:

a) Shkeljet e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij neni dënohen me gjobë në masën 20 mijë deri në 50 mijë lekë.

b) Shkeljet e përcaktuara në shkronjat “c”, “ç” dhe “d” të pikës 1 të këtij neni dënohen me gjobë në masën 20 mijë lekë.

c) Shkeljet e përcaktuara në shkronjën “dh” të pikës 1 të këtij neni dënohen me gjobë në masën 20 mijë lekë.

ç) Shkeljet e përcaktuara në shkronjat “e”, “ë”, “f” dhe “g” të pikës 1 të këtij neni dënohen me gjobë në masën 20 mijë lekë.

d) Shkeljet e përcaktuara në shkronjat “gj” dhe “h” të pikës 1 të këtij neni dënohen me gjobë

në masën nga 10 mijë deri 20 mijë lekë.”

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2850, datë 26.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**